

KONFERENCA IPESHVORE E SHQIPËRISË



# Zoja e Shkoders Drita e Shqypniës

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBETARE



BOTIMET  
FISHTA

KONFERENCA IPESHVORE E SHQIPËRISË

**ZOJA E SHKODERS  
DRITA E SHQYPNIËS**

**Konferenca shkencore ndërkombëtare**

**Shkodër, 22 prill 2017**

**Shkodër, 2017**

ZOJA E SHKODERS DRITA E SHQYPNIËS

Konferenca shkencore ndërkombëtare, me rastin e 550 vjetorit  
të zhvendosjes së figures së “Zoja e Këshillit të Mirë”, në Gjenacano - Itali  
Shkodër, 22 prill 2017

*Redaktor:*

Dom Nikë Ukgjini

*Përgatiti për botim:*

Dom Artur Jaku

Dom Nikë Ukgjini

*Kujdesi grafik:*

Gjergj Spathari

*Botues:*

Enti Botues “Gjergj Fishta”

Lezhë, 2017

## PASQYRA E LËNDËS

Parathënie .....	7
Introduzione .....	9
Përshëndetje .....	11
<b>KUMTESAT:</b>	
Edmond MALAJ	
<i>Urdhra kishtare në Shkodër dhe rrethina gjatë mesjetës</i> .....	19
Peter ROCCO RONZANI	
<i>Diuinitus apparuit. Cinquecentocinquanta anni della "venuta" della Madonna del Buon Consiglio</i> .....	47
Dom Gjovalin SIMONI	
<i>Përshpirtëria dhe devocioni ndaj "Zojës së Këshillit të Mirë": Pajtorja e popullit shqiptar</i> .....	63
Andrea Di GIUSEPPE	
<i>Un tempo dall'Albania partita: Un'iconografia mariana tra Italia e Albania...</i>	76
Nevila NIKA	
<i>Trajtimi i problemeve shoqërore dhe ekonomike nga kleri katolik shqiptar gjatë shek. XIX</i> .....	110
Mons. Luis MANUEL CUÑA RAMOS	
<i>Di Propaganda Fide riguardante l'Albania nei secoli XIX E XX: Testimonianza della cura pastorale della Santa Sede</i> .....	122
Dom Nikë UKGJINI	
<i>Shenjtërorja "Zoja e Shkodrës" në përballje me rrebeshet historike (shek. XV-XX)</i> .....	149
Lucia NADIN	
<i>Il culto della Madonna del Buon Consiglio in area Veneziana. Antiche testimonianze</i> .....	194
Giuliana DALL'OLIO	
<i>La Madonna del Buon Consiglio nella pala di sanzeno: un'indagine tra documenti d'archivio e iconografia</i> .....	209
Enrico SARTORI	
<i>Ha dato un Buon Consiglio, ma ...</i> .....	218
Italo SARRO	
<i>Pagine italiane sul culto della Madonna del Buon Consiglio</i> .....	224
Evalda PACI	
<i>Motive përshpirtnie e devocioni në krijime, kushtue figurës së Zojës së Këshillit të Mirë</i> .....	242

Valentina DELBIANCO <i>La Madonna del Buon Consiglio: la diffusione settecentesca dell'iconografia fra Italia e Germania. Il caso del trentino</i> .....	254
<b>Fatbardha SHKUPI</b> <i>Zoja e Shkodrës, Nana e Këshillit të Mirë, pajtorja e Shqipërisë (e vërteta historike)</i> .....	267
Gentian VOKOPOLA <i>Rezultate të investigimit in-situ të pikturës murale "Zoja e Këshillit të Mirë" në Genazzano</i> .....	275
Edlira ÇAUSHI <i>Të dhëna mbi teknikën e realizimit të pikturës murale</i> .....	287
Nikolla CIVICI <i>Identifikimi i pigmenteve inorganikë përmes metodës së fluoreshencës së rrezatimit X</i> .....	297
Paolo SATURNO <i>Caratterizzazione minero-petrografica preliminare dell'intonaco nel dipinto murale raffigurante la madonna del buon consiglio a genazzano (roma)</i> .....	308
Paolo SATURNO Edlira ÇAUSHI <i>Considerazioni su alcuni aspetti e verifiche dello stato conservativo dell'opera e i suoi materiali costitutivi</i> .....	322
<b>SHTESË</b>	
<i>Kronikë: Imazhi i Zojës së Shkodrës, kthehet në shtëpinë e vet</i> .....	331
Imzot Angelo MASSAFRA <i>Sot duam të kremtojmë një bukuri të plagosur dhe të rigjetur</i> .....	333
Dom Artur JAKU <i>Figura e Zojës së Shkodrës, është një gjerdan i çmueshëm që rrethon këto festime</i> .....	336
Mirela KUMBARO <i>Zoja e Shkodrës meritonte jo vetëm nderim shpirtëror por edhe dinjitet artistik</i> .....	339
Ilustrime .....	343
Përmbyllje .....	354

**Edmond MALAJ**

*Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë*

## URDHRA KISHTARE NË SHKODËR DHE RRETHINA GJATË MESJETËS

Gjatë periudhës së Mesjetës, përsa i përket përkatësisë klerit katolik të Shkodrës, arrijmë në konkluzionin që në krahinën e Shkodrës kanë qenë të pranishëm kryesisht urdhrat e benediktinëve, dominikanëve, françeskanëve, pastaj më vonë në cilësinë e ipeshkvijve titullarë të Drishtit përmenden të tillë që i përkisnin edhe urdhrave të norbertinëve (premonstratensëve), augustinianëve dhe mercedarianëve. Unë do të ndalem kryesisht mbi praninë e tre urdhrave të parë të mëdhenj që janë të dokumentuar në Mesjetë në Shkodër dhe rrethinat e saj, këto janë benediktinët, dominikanët dhe françeskanët dhe përveç këtyre kemi të pranishëm edhe klerin dioqezan, për të cilin do të them nja dy fjalë në fund të këtij artikulli.

### **Benediktinët**

Urdhri Benediktin (O. S. B.) u ngulit mirë qysh në kohërat e hershme si në trojet shqiptare ashtu edhe në Dalmaci, përgjatë gjithë bregdetit të Adriatikut, nga Budva deri në Durrës dhe depërtoi në brendësi të vendit.<sup>1</sup> Në lidhje me historinë e këtij urdhri po ndalem pak më gjatë pasi benediktinët kanë një rëndësi të veçantë në historinë e krishterimit katolik në Shqipëri. Në trojet

<sup>1</sup> Milan von Šufflay, "Die Kirchengestaltung im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damm", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 268.

shqiptare ka pasur një numër të konsiderueshëm manastiresh benediktine, dhe disa pre tyre kanë një moshë shumë të hershme.<sup>2</sup>

Benediktinët si figurë inspiruese të tyre kanë Shën Benediktin e Nursia (Norcia) (rreth 480/90 – 553/60), i cili krijoi “Rregullat e Shën Benediktit” (lat. *Regula sancti Benedicti*), të cilat janë orientuese në jetën dhe në aktivitetin e urdhrit.<sup>3</sup> Një ndër rregullat kryesore të tyre është “*Puno dhe Lutu*” (*ora et labora*), që është rregulli dallues dhe divizë e tyre. Për nga lloji Benediktinët janë një urdhër kontemplativ.

Kontemplacioni është diçka mistike në krishterim që do të thotë, t’i hapesh Shpirtit të Hyjit dhe kjo ndodh ndërmjet tre hapave: purifikimit, ndriçimit shpirtëror dhe bashkimit shpirtëror me Hyjin, që sipas metodës benediktine arrihet nëpërmjet leximit (*lectio*) meditimit (*meditatio*) dhe lutjes (*oratio*). Edhe në krahinën e Shkodrës prania e tyre është më se e dokumentuar. Në Shkodër ky urdhër, me kongregacionin e tij të Shën Maurit/Mauricios<sup>4</sup>, vepronte jo vetëm në qytet, por më tepër edhe në hinterland dhe kishte manastiret e tij jo shumë larg Shkodrës. Në lidhje me kongregacionin e Shën Mauricit mund të përmendim, që emri i këtij shenjtori është shumë i përhapur në zonat përreth Shkodrës, si p.sh., në emriat e lokaliteteve Muriqani në Anë të Malit (rrethi Shkodrës), apo Muriqi në Krajë (Mali i Zi).

Ndër manastire së pari mund të përmendim brenda Shkodrës *Manastirin Benediktin* të njohur më vonë si “*Shtëpia e vezirëve(?)!*”. Ky manastir përmendet nga Gjush Sheldija në relacionin e tij të vitit 1958.<sup>5</sup> Ai duhet të kërkohet në lagjen e dikurshme Alibegaj të Shkodrës, duke marrë rrugën e vjetër për tek lagja e Tabakëve, nëpërmes urës së Drinit, e cila nuk është më e përdorshme, ose para urës, nën muret e kështjellës<sup>6</sup>.

Sipas Sheldijs, mbi mbeturinat e këtij manastiri që vendosur më vonë

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> *Wörterbuch des Christentums*. 1500 Stichwörter von A bis Z. Hrsg. v. Volker Dresen [u. a.] Genehm. Sonderausg. München: Orbis 2001, f. 137.

<sup>4</sup> Po aty, f. 307.

<sup>5</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 10.

<sup>6</sup> Lec Shllaku, *Shtegtimi i Monumenteve*. (Studim), Shkodër: Enti bot. “Gjergj Fishta” 2004, f. 57.

shtëpia e Bushatllinjve,<sup>7</sup> por këto të dhëna bien ndesh me të dhënat që jep Lec Shllaku, i cili thotë që ky manastir ndodhej poshtë kalasë dhe lidhej me të nëpërmjet njëres degë të tunelit të nëndheshëm që zbriste me shkallë elokoidale nga oborri i kalasë.<sup>8</sup> Dega tjetër e lidhte kalanë me Kishën e Shën Vlashit.<sup>9</sup> Hyrja e këtij tuneli ekziston edhe sot e kësaj dite dhe deri në një farë thellësie mund të zbritet me shkallë, por pastaj të dy krahët e tuneleve janë të shembura.

Rrënojat e këtij manastiri, siç tregon L. Shllaku, shiheshin pjesërisht në këmbë deri nga viti 1936, të cilat përdoreshin si një vendstrehim karburantesh, por për shkak të një shembjeje të madhe të mureve rrethuese që braktisur përfundimisht deri sa nuk mbeti shenjë prej tyre. Rizbulimi i tyre u bë nga gërmimet arkeologjike në vitet 80.<sup>10</sup> Më vonë gjatë viteve 1992-2000, kjo zonë arkeologjike, e lënë në mëshirë të fatit, e pambrojtur nga shteti, u zu nga persona të ndryshëm dhe aty u bënë lloj-lloj ndërtimeve duke fshirë njëherë e përgjithmonë gjurmët e këtyre monumenteve mesjetare.

Më tej, përreth Shkodrës mund të përmendim abacinë benediktine të Shën Shirqit dhe të Shën Bakut (lat. *sanctorum Sergii et Bachi*; slav. *Sveti Srgj*)<sup>11</sup>, në fshatin e sotëm Shirq (6 km larg Shkodrës), abacinë benediktine të Shën Kollit të Drinit<sup>12</sup> (*San Nicoli de Drino*) në breg të Bunës\* në afërsi të Shtoj të Ulqinit,<sup>12</sup> manastirin benediktin të Shën Gjinit të Strilalit, më tej abacinë e Shën Sofisë së Zetës në Dejë<sup>13</sup>, manastirin e Shën Palit të

<sup>7</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 10.

<sup>8</sup> L. Shllaku, Shtegtimi i monumenteve, f. 57.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> "Petro, abbate (archimandrita) sanctorum Sergii et Bachi" Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen. (AAlb. I), nr. 93.

\* Në fakt me termin *de Drinoi*, nuk bëhet fjalë për Drinin por për Bunën. Në mesjetë, në disa burime dhe dokumente lumi Bunë quhet Drin. *Shih* AAlb. I, nr. 93.

<sup>12</sup> "abbatia s. Nicolai de Drino diocesis Dulcinensis (a. 1346) seu "de Bojana" in ostio humus fluminis". AAlb. I, nr. 613.

<sup>13</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 268.

Pultit, manastirin benediktin të Shën Marisë së Ndërfandinës (*S. Maria de Nderfandena*), manastirin e Shën Shëlbuesit i Rubikut (*S. Salvador de Rebico ose Arbanensis*) që u mor përsipër më vonë nga françeskanët.<sup>14</sup>

Po në veri gjendeshin edhe manastiret benediktine e Shën Salvatorit në Tivar,<sup>15</sup> të Shën Mërisë së Rotecit po në Tivar, të “Shën Lleshit të Malit të Oroshit” (*S. Alexander de Monte de Oroši*) dhe të Shën Prendës së Kurbinit (*S. Venera / S. Veneranda*). Në zonën e kepit të Rodonit në Durrës gjendeshin kuvendet benediktine të Shën Anastazias (*S. Anastasia monasterium*) të përmendur për herë të parë në vitin 1324 dhe Shën Marisë së Rodonit (*monasterium S. Maria de Rodono*) që përmendet në vitin 1418.<sup>16</sup> Të gjitha këto manastire, me përjashtim të ndonjë kishe që është rindërtuar në vendin e tyre, sot nuk gjenden më. Ato u shkatërruan kryesisht nën sundimin osman. Ndër këto manastire që përmendëm më sipër ja vlen të ndalemi veçanërisht në dy prej tyre ngaqë ndodheshin vetëm disa kilometër në Afërsi të Shkodrës. Këto janë Manastiri i Shën Shirqit dhe i Shën Bakut në Shirq dhe Manastiri i Shën Gjonit në Shtoj.

*Manastiri i Shën Shirqit dhe Shën Bakut* që ndodhej në bregun e majtë, jugor të lumit Buna, 12 milje larg grykëderdhjes së Bunës dhe 6 milje larg Shkodrës,<sup>17</sup> ka qenë një vend shumë i rëndësishëm në këtë lumë, pasi ndodhej në zemër të një rrjeti shumë të rëndësishëm tregtar, i cili duke u nisur nga qendra e Evropës dilte në detin Adriatik, pikërisht duke kaluar edhe nga Shirqi.<sup>18</sup> Ne nuk e dimë se, kur dhe prej kujt u themelua ky manastir.

<sup>14</sup> “*Giorgio abbate sancti Salvatoris Antibarensis*” *Haud dubie ecclesia “Šelbuemit” (s. Salvatoris) in Rubigu (regio Miriditarum) ad ostiom fluminis Fandi, quae hodie integra subest Francescanis.*” AAlb. I, nr. 93, ref. 5.

<sup>15</sup> “*Johanne abbate sancti Salvatoris Antibarensis*”. AAlb. I, nr. 93.

<sup>16</sup> “*apud s. Nastasiam a li Rodoni*” *Promontorium in sinu Drini (golfo dello Drino), de cuius situ v. Itinerarium Johannes Giustiniani. S. Anastasia monasterium erat ibidem situm. A. 1418 aliud etiam monasterium S. Maria de Rodono memoratur.*” AAlb. I, nr. 694, ref. 1.

<sup>17</sup> Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 117.

<sup>18</sup> Lucian Nadin/ Mario Bnaldi, “Il prsebitero albanese Girolamo Messio, la chiesa di San Sebastiano a Venezia, le pitture di Paolo Veronese”, në: *Il Veltro. Rivista della Civiltà*

Ndërtimi për këta dy shenjtorë sirian Shën Shirqin dhe Shën Bakun arriti kulmin në shekullin e 6-të në kohën e sundimit të perandorit Justinian, i cili u shuguroi këtyre dy martirëve të krishterë edhe një kishë të madhe në Kostandinopojë.<sup>19</sup>

Presbiteri Diokleas informon se në abacinë e kishës së Shën Shirqit janë gjendur dikur edhe varret e mbretërve dioklitë të shekujve XI dhe XII, pra varret e Mihaelit, Bodinit dhe të pasardhësve të tyre.<sup>20</sup> Aty kishin mbetur akoma mbishkrimet latine nëpërmjet rinovimit të Kishës nga mbretëresha Helenë dhe nga bijtë e saj, mbretërit Stafani (Dragutini) dhe Stafan Uroshi II (Milutini) në vitet 1290 dhe 1293,<sup>21</sup> dhe këto mbishkrime të




Fig. 1. Mbishkrimi i Helenës (1290) në Kishën e Shirqit.  
Popa, Mbishkrime të Kishave, f. 329.




Fig. 2. Mbishkrimi Stefan Uroshit II (1318) në Kishën e Shirqit.  
Popa, Mbishkrime të Kishave, f. 330

gdhendura në gurë të mëdhenj, i pari me përmasa 1.45x0.64 x0.28 m dhe i dyti 2.40x0.32x0.38 m gjenden sot në Muzeun Historik Kombëtar Tiranë, dhe

*Italiana*. Nr. 4-6, anno LX – Luglio-Dicembre 2016, f. 104.

<sup>19</sup> K. Jireček, "Skutari...", f. 117.

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> "Riprodhimet më të mira të këtyre monumenteve gjinden tek Ippeni në "Wiss. Mitt. 7, 232" po aty.

janë gjetur në vitin 1953 të rënë në lumin Bunë, dhe pasi u nxorën nga uji u vendosën fillimisht në Muzeun e Shkodrës.<sup>22</sup>

Sipas Ippenit, kisha e këtij manastiri është rindërtuar dhe jo meremetuar<sup>23</sup>, me ndihmën e abatit Pjetër Dohne –Shkodranit, dhe kjo na dëshmohet edhe nga mbishkrimet e lartëpërmedura, që po i japim si më poshtë. Mbishkrimi i Helenës (1290) është si më poshtë:

Kujtoje o Zot shërbëtoreshën tënde Helenën mbretëreshën e Serbisë, Dioklesë, Shqipërisë, Hilmës, Dalmatisë dhe krahinës bregdetare, e cila bashkë me të bijtë e saj, mbretërit Urosh dhe Stefan ndërtoi përsëri këtë kishë për nder të dëshmorëve të lumtur Sergjit dhe Bakut dhe e kreu plotësisht në vitin e Zotit 1290.<sup>24</sup>

*Teksti në Latinisht:* Mem(en)to Domine famule tue/ Helene Regine Servie, Dyo/ clie, Albanie, Chilmie, Dalm/acie et Maritime Regionis, que una cu(m) filiis suis reg/ ib(ubs) Urosio et Stepha(n)e edifica /vit de novo istam eccl(es)ia(m) ad hono/ re(m) beatoru(m) m(a)rtiru(m) Sergii et / Bachi et ad fine(m) usq(ue) co(m)plev / it ann(o) D(omi)ni MCCLXXXX (=1290)<sup>25</sup>

Kurse mbishkrimi i Stefan Uroshit II është i datës 1318, i përket rindërtimit të kësaj kishe dhe ka përmbajtje e mëposhtme:

*Teksti në Latinisht:* In Nomine Domini Amen. Eximie Virginis Filio anno M.X.V.I.I.I. magnificus Dominus Dominus Urosius Dei gratia / Basie rex illustri magnifici regis Urosii natus (atque) D(omi)ne Helene regine edificavit ha(n)c ecc(lesiam) / in (h) onore(m) s(anct(t)oru(m) m(artirum) (Ser)gii et Bacchi a fundam(en)tis u(s)que afin(em), (asis) tente Abbate Petro Dochne Scutaren(si).<sup>26</sup>

Në emër të Zotit, Amin. (Në kohën) e birit të Virgjëreshës së Lartë, në vitin 1318, Zoti i madhëruar Urosh, me hir të Perëndisë mbret i Rashës, lindur prej të madhërishtit dhe të shkëlqyerit mbret Uroshit dhe (prej) Zonjës mbretëreshë Helenë ndërtoi këtë kishë për nder të shenjtoreve dëshmorë Sergjit dhe Bakut, prej themeli gjer në mbarim, me ndihmën e Abatit Pjetër Dohne – Shkodranit.<sup>27</sup>

<sup>22</sup> Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave Të Shqipëri*, Tiranë: Akademia e Shkencave (Instituti i Historisë) 1998, f. 330.

<sup>23</sup> Theodor Ippen, *Shqipëria e Vjetër*. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër. Përkthyer nga origjinale: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi. Me riprodhimin e fotografimeve dhe sikkave origjinale të Ippenit. Tiranë: K&B 2002., f. 115.

<sup>24</sup> Burime. Vëll. II. Shek. VIII-XV, Nr. 121, f. 193.

<sup>25</sup> Th. Popa, *Mbishkrime të Kishave*, f. 330.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Vëllimi II. Shek. VIII-XV. Përgatitur

Ky rindërtim i dytë, duket së është bërë për shkak se uji i Bunës e kishte rrënuar të parin, dhe kisha u ngrit, sipas Popës, në vendin e ndonjë kapele që kishte ekzistuar më parë, ndoshta dedikuar Shna Premtes, pas kjo kishë nga populli përreth quhet edhe Kisha e Shna Premtes.<sup>28</sup> Me këtë emër e përmend dhe ati françeskan Kostandin Konaj në fillim të shekullit XX.<sup>29</sup> Arqipeshkvi i Tivarit Marin Bici në një relacion të tij në vitin 1610 dërguar Papës Palë V shkruan se kisha ishte “e ndërtueme Madhnisht dhe që zen 3 mijë vetë. Në të kaluemen rrinin



Fig. 3. Abacia e vjetër benediktine të Shën Shirqit dhe Shën Bakut, Shkodër.  
Foto: Degrand, Souvenirs... (1890), f. 95.

aty murgët e shën Benediktit, me t'ardhuna të mëdha, që tash i kanë shtimë dorë turqit. Dhe kishën vetë e keqpërdornin meqë janë thye mermerët ma të mirë që ishin aty, u janë nxjerrë sytë të gjitha fytyrave të shenjtëve, veç asaj së shën Gjergjit dhe shën Mëhillit që ata i nderojnë disi.”<sup>30</sup> Në vitin 1685 aty, pranë kishës ngrihej një kampanjel i lartë dhe i bukur (bellissimo campanile), nga ku mund të shihej e gjithë rrafshina.<sup>31</sup>

Para njëqind vjetësh, (në kohën kur Jireçeku shkroi artikullin mbi Shkodrën dhe rrethinat e saj në mesjetë) kisha e Shën Shirqit është një rrënojë e shkretë, një ndërtesë e madhe me tri anijata dhe tre altarë, me mure që përbëheshin nga shtresa alternuese, guri dhe tulle, me mbetje nga një dysHEME me mozaik dhe

nga: Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pipo. Tiranë: Univ. Shtetëror i Tiranës 1962., Nr. 122, f. 193.

<sup>28</sup> Popa, Mbishkrime të Kishave, f. 330.

<sup>29</sup> Kostantin Konaj, “Te rrënimet e njëj kishës së hershme”, në: *Hylli i Dritës* 1931, nr. 4, f. 235.

<sup>30</sup> “Relacion i Marin Bicit 1610”, në: *Relacione. Vëllimi I (1610-1934)*, f. 103.

<sup>31</sup> K. Jireček, “Skutari...”, f. 118.



Fig. 4. Pjese e murit të Abacisë benediktine të Shën Shirqit dhe Shën Bakut në Shirq, Shkodër.  
Foto: Edmond Malaj 2011.

me gjurmë nga afreske të vjetra në dy shtresa mbi njëra tjetrën.<sup>32</sup> Çatia i mungonte, brenda kishës ishin rritur pemë dhe në njërën anë muret ishin gërryer shumë nga uji i Bunës.<sup>33</sup> Sot nga gjithë ajo kishë nuk ka mbetur asgjë vetëm një faqatë muri.

Tani në lidhje me zhvillimin e ekonomik të Shriqit, pranë manastirit gjendej një shesh që kryente funksionin e një porti për anijet tregtare, një zyrë doganore

dhe një magazinë kripe. Prandaj flitet kaq shumë për “*Sanctus Sergius*” ose për “*portus Sancti Sergii de Drino (Oldrino)*”, serbisht “*Sveti Srgj*” në dokumentet mesjetare sidomos të atyre të Raguzës.<sup>34</sup> Për vitin 1377 përmendet edhe një “treg vjetor” (*panagjur*) në Shën Shirq. Mallrat që importoheshin aty ishin pëlhura, verë nga Dalmacia dhe Italia dhe kripë deti, etj., kurse mallrat që eksportoheshin prej aty ishin lëndë druri, dyllë, kallaj dhe argjend nga Serbia, peshk nga Shkodra, etj.<sup>35</sup>

Kështu Shën Shirqi ishte një vend shumë i rëndësishëm, jo vetëm për tregtinë e atyshme të kripës por edhe si pikë transiti mallrash, si një ndër stacionet e rrugës tregtare për në Prizren, dhe kjo lidhje ishte shumë e rëndësishme për Raguzën, sepse në afërsi të Prizrenit, në Novobërdë kishte tashmë një ekonomi të rëndësishme të lidhur me nxjerrjen e mineraleve.<sup>36</sup>

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Po aty..

<sup>34</sup> Po aty, f. 117.

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> Irmgard Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung”, në: *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII. – 1. IX. 1966. Hrg. v. Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft. München: Trofenik 1966, f. 352.

Pra, sot ne dimë diçka në lidhje me rëndësinë ekonomike të këtij manastiri kurse në lidhje me rëndësinë fetare dhe kontributet e tij për religjionin dhe kulturën e krishterë, për shkak të mungesës totale të burimeve nuk dimë asgjë. Cilët ishin abatët dhe murgjit e këtij manastiri? Cili ishte aktiviteti i tyre? Çfarë biblioteke kishte? Për këto pyetje dhe shumë të tjera historia heshtë.

Manastiri tjetër i rëndësishëm benediktin në afërsi të Shkodrës ishte edhe ai i Shtojit një njihej me emrin Abacia e Shën Gjonit të Rashit (*abbatia s. Johannis de Strilalio districtu Drivasti*).<sup>37</sup> Ky manastir benediktin në dokumente të ndryshme ndeshet me emra të ndryshëm si *Manastiri i Shën Gjonit, i urdhrit Benediktin, i dioqezës së Drishtit (monasterium s. Johannins Ordinis s. Benedicti Drivastensis diocesis)* në vitin 1357, apo *Abacia e Shën Gjonit të Strilalit të distriktit të Drishtit* në vitin 1408 (*abbatia s. Johannis de Strilalio districtu Drivasti*), apo ‘*Manastiri i Shën Gjonit të Strilalit, i urdhrit Benediktin, i dioqezës së Drishtit*’ (*monasterium s. Johannins de Strilalio Ordinis s. Benedicti Drivastensis diocesis*) në vitin 1459.<sup>38</sup>

Kjo abaci ndodhej vetëm disa kilometra të afërsi të Shkodrës dhe i përkiste Ipeshkvisë së Balecit. Rrënojat e këtij manastiri, të përbëra nga një kullë katërkëndëshe me mbetjet nga kisha dhe nga ndërtesat e manastirit ndodhen në fushën e Shtojit, në veri-perëndim të qytetit të Shkodrës, tek fshati Rash-Kullaj (Raši). Dhe në fillim të shek. XX<sup>39</sup> ato ishin në një gjendje më të mirë nga ç’janë sot. Aty në afërsi kalon edhe përroi i Banushit dhe në afërsi të tij gjindej edhe rruga mesjetare që të çonte për në Balc,<sup>40</sup> Kjo rrugë duhet të ketë lidhur edhe Drishtin qoftë me manastirin, qoftë me qytetin e Balecit. Më tej kjo rrugë të çonte në Koplik.<sup>41</sup> Manastiri është i mbuluar edhe me legjenda popullore, njëren ndër të cilat na e sjell edhe ati jezuit Fulvio Kordinjano.<sup>42</sup>

<sup>37</sup> Në lidhje me të dhënat historike të manastirit shih edhe librin tim me titull: Edmond Mala, *Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar. Drishti*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjine 2016, f. 334-341

<sup>38</sup> AAlb. I, nr. 93, ref. 3.

<sup>39</sup> AAlb. I, nr. 93, ref. 3. Shih edhe K. Jireček, “Skutari”, në: *Forschungen I*, f. 114.

<sup>40</sup> Fulvio Cordignano “Antichi monasteri benedettini e le loro benemerenze sociali in Albania”, në: *La Civiltà Cattolica*. Anno 80 – 1929, vol III, f. 17.

<sup>41</sup> Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*. München: Oldenburg 2001, f. 85.

<sup>42</sup> “Legjenda tregon se themelueset ishin tri motra mbretëresha, të bijat e një mbreti që vdiq



Fig.5. Rrënojat e manastirt sot, me këmbanaren e riparuar në vitin 2012. Foto E. Malaj.

Moshën e këtij manastiri nuk mund të përcaktojmë dhe nuk e dimë se kush e ka themeuar.

Manastiri nëpër dokumente përmendet për herë të parë më 16 qershor të vitit 1166 në aktin e shugurimit të kishës së Shën Trifonit në Kotorr, ku përveç ipeshkvit të Kotorrit Maio, ipeshkvit të Arbrit Lazrit, (*Lazaro Albanensi*), ipeshkvit të Ulqinit Gjonit (*Johanne episcopo Dulcinensi*), morën pjesë dhe

shumë abatë, ndër ta dhe *Mihaeli*, abati e manastirit benediktin të Shën Gjonit të Shtojit (*Strilalio*),<sup>43</sup> siç quhej në një dokument tjetër, manastiri i Rashit.

pa lënë djem. Edhe ato për të lënë një emër të lavdishëm vendosin të ndërtojnë tri kisha për "sevap" edhe për dashurinë ndaj Hyjit. Këto kisha ishin: ajo e Shurdhahut (Sardës), ajo e Shatit, kurse e treta ajo e Rashit. Këto tri kisha duhej të ishin njësoj dhe këmbanaret e tyre duhej të kishin të njëjtën lartësi, në mënyrë që motrat, nga këmbanaret e tyre të mund të shiheshin, të thërrisnin dhe të bisedonin me njëra tjetrën kur të donin. Kisha e Rashit, njësoj si dy kishat e tjera simotra, kishte sipas legjendës 366 altare, pra çdo ditë të vitit i ishte caktuar një altar. Ndërsa një legjendë tjetër, e sjellë po nga Kordinjano, nuk përmend tri motrat mbretëresha, por një murgeshë të vjetër, si themeluese të këtyre tri kishave." F. Cordignano, "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929/IV, 107, f. 410-12.

<sup>43</sup> "1166, 19. Iunii, <Cathari> Maio episcopus <Catharensis> cum "episcopis Lazaro Albaniensis et cum et cum Martino Drivastensis et cum Johanne episcopo Dulcinensi" "adiunctis abbatibus: Michaelle abbate (archimandrita) Sancti Johannis et cum Petro abbate (archimandrita) sanctorum Sergii et Bachi et Johannes abbate sancte Salvatoris Antibareinsis et Petro abbate sancti Michaelis Catarens et Triphone abbate sancte Marie Buduensis et petro abbate sancti Petri et Johannes abbate sancte Georgii et georgio abbate sancti Salvatoris Arbanensis" ecclesiam sancte Triphoni consecrat, quidem altare medium ipse Maio, "aliud altare a sinistro latere sacravit Lazarus", "a dextro videlicet latere sacravit altare Johannes episcopus Dulcinensis". "in sede apostolica residente papa Alexandro, imperante piissimo et temper triumphatore Hemanuele, duce existente Dalmatie atque Dioclie kyr Izancio, qui in eadem dedicatione sua gratuita voluntate et benignitate affuit, priore Vita existente in Cataro; Petrus Soacinensis electus interfuit et Andreas prior Arbanensis cum toto populo civitatis." AAlb. I, nr. 93. Krahaso edhe: F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 17.

Drishtjanët e konsideronin manastirin pronë të tyren dhe sipas një dekreti të qartë të shek. XV, abati i manastirit duhej të ishte gjithmonë një drishtjan (*semper in futurum abbas sit Drivastinus*).<sup>44</sup>

Ngaqë të ardhurat e kishës së Balcit në këtë kohë qenë pakësuar aq shumë nga skizmatikët e Mbretërisë së Rashës, ipeshkvi i Balcit nuk kishte me se të jetonte, dhe për këtë arsye, atij, nga Papa Inocenti VI, rreth datës 26. 10. 1356 iu dha si komendë manastiri benediktin i Shën Gjonit në Shtoj (Strilaleo) që ndodhej në dioqezën e Drishtit.<sup>45</sup> Pra, dioqeza e Drishtit, por edhe rrethi përfshinin brenda tyre edhe fushën e Shtojit deri në afërsi të qytetit të Balcit. Ky manastir pati probleme të shumta nga ortodoksët sllavë, ashtu siç pati edhe ipeshkvia e Balcit në afërsi të tij, sepse në vitin 1356 thuhet se Abacia e Shën Gjonit në Drisht ishte shkatërruar krejtësisht nga ortodoksët (*ab ipsius schismaticis quasi totaliter dissipatum*).<sup>46</sup> Gjatë kësaj kohe posti i abatit të manastirit ishte vakant, sepse abati i saj më i fundit që quhej Andrea, kishte vdekur.<sup>47</sup> Papa Inocenti me këtë rast bën edhe një histori të shkurtër dhe një përshkrim të dioqezës së Balcit. Në atë kohë ipeshkëv i Balcit ishte Andrea.<sup>48</sup>

Ky manastir, me gjithë kërcënimin skizmatik, u ringrit shumë shpejt, pasi

<sup>44</sup> K. Jireček, "Skutari", në: *Forschungen I*, f. 114; Shih edhe: M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 270. Shih edhe: F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

<sup>45</sup> AAlb. II, nr. 119. Shih edhe: F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

<sup>46</sup> "(1356) 26 octobris. Innocentius VI. papa, "Andree episcopo Balazensi" "monasterium S. Johannis ordinis S. Benedicti Drivastensis diocesis in regno Rassie consistens et ab ipsius regni schismaticis quasi totaliter dissipatum, per obitum quondam Andree ultimi abbatis dicti monasterii, qui catholicus exstitit et extra Romanam curiam diem clausit postremum, vacans, quod ab ecclesia Balazensi per quinque dumtaxat milliaria parva distat – dat in commendam, ne mendicare cogatur, ecclesia Balazensi in prefato regno consistente ab eisdem schismaticis destructa" AAlb II, nr. 119. Shih edhe: M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 278.

<sup>47</sup> Giuseppe Valentini / Fulvio Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh për historinë e Shqipërisë (1200-1500)*. Përktheu nga origjinali: Vladimir Bregu. Tiranë: Plejad 2013. (= Plejada e Mendimit albanologjik. Seria "Valentini") nr. 130; *Krahaso edhe*: AAlb. II, nr. 119.

<sup>48</sup> Giuseppe Valentini/ Fulvio Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh për historinë e Shqipërisë (1200-1500)*. Përktheu nga origjinali: Vladimir Bregu. Tiranë: Plejad 2013, nr. 130.

20 vjet më vonë gjejmë se Papa Gregori XI urdhëron më 29. 2. 1376 Pjetrin, arqipeshkëv të Raguzës, që të zgjedhë ndonjë murg benediktin të atyre vendeve dhe që ta caktojë si abat, pasi abati i fundit Mihael kishte vdekur “*monasterio S. Johannis Baptiste dicti ordinis Drivastensis diocesis, per obitum Michaelis abbatis vacanti*”<sup>49</sup>. Pra, për shek. XIV mësojmë emrat e dy prej abatëve të këtij manastiri, që ishin Andrea dhe Mihaeli.

Gregori XI i propozon arqipeshkvit Pjetër të Raguzës, që Mihaeli, abati i vdekur i këtij manastiri të zëvendësohet ose nga Paska (Pascha) që ishte prior (igumen) i Shën Mikelit të Peklinës (S. Michele di Peclina), ose nga murgu shqiptar Paolo Bossato (Bushati), i cili në atë kohë shërbente në kishën e Shën Mërisë në ishullin Treme (S. Maria di Treme), ose nga ndonjë tjetër.<sup>50</sup> Se cili u vu në krye të manastirit, këtë nuk mund ta mësojmë nga dokumentet dhe literatura deri tani të disponueshme, por historia e manastirit vazhdon edhe më tej dhe aty këtu hasim edhe të dhëna të tjera sporadike, të cilat po i jap edhe më poshtë.

Më 7 maj të vitit 1403, senati i Venedikut me anë të presbiterit Andrea që ishte ambasador i komunitetit të Drishtit, i dërgon një përgjigje negative kërkesës së abatit të këtij manastiri, për të mos pagur taksën e një të dhjetës.<sup>51</sup> Emri i abatit në këtë dokument nuk përmendet. Kur në vitin 1437, arqipeshkvi i Korfuzit u emërua si komendatar i manastirit, papa ia këshilloi atë edhe despotit serb.<sup>52</sup>

Kur plasi lufta midis Balshës III dhe Venedikut abatët e këtij manastiri që ishin me Venedikun vuajtën shumë për çështjen e Republikës.<sup>53</sup> Manastirit iu

<sup>49</sup> Rrënojat e Manastirit në Rrash-Kullaj, Boriç – Malësi e Madhe (Shqipëri) URL: <http://www.kishakatolikeshkoder.com/famullite/Manastiri%20i%20Shen%20Gjinit/Manastiri%20alb.htm> (2. 8. 2012). Krahaso edhe: G. Valentini/ F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr. 163.

<sup>50</sup> G. Valentini/ F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr. 163.

<sup>51</sup> “1403, 7. maii. Venetiis. Petitioni, ne possessiones abbacie s. Johannis de Strilialio de districtu Drivasti deciman solvant, non complacetur, cum dicte possessiones rusticis affictentur”. AAlb. II, nr. 728. Shih edhe: Cordignano, “Antichi monasteri”, në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

<sup>52</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f. 271.

<sup>53</sup> Po aty. Shih edhe: F. Cordignano “Antichi monasteri”, në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

bënë shumë dhurata nga venedikasit. Ndër të tjera, atij, në vitin 1445 iu dhurua edhe një fshat i tërë (*villa Veronika*).<sup>54</sup> Abati i këtij manastiri përmendet për herë të fundit në vitin 1459 në regjistrat e papës Piu II, por mesa duket pa emër.<sup>55</sup>

Ky manastir, të cilit i kishin dhuruar edhe despotët serbë po aq shumë sa edhe manastirit të Shën Shirqit, apo abacisë së Rotecit, gëzonte një respekt të madh gjatë shekujve edhe nga popullsia ortodokse e krahinave përreth; madje akoma në shek. XIX (1855-1869) ortodoksët sllavë të Vrakës dhe katolikët e Rash-Kullajve u grindën egër para kajmekamit turk, për të pasur rrënojat e manastirit. Kajmekami kësaj gjendjeje i dha fund duke vënë përreth rrënojave një gardh dhe duke iu ndaluar të dy konfesioneve që të bënin shërbesa fetare tek këto rrënoja.<sup>56</sup> Ai i deklaroi rrënojat si pronësi muslimane, dhe kështu siç njoftojnë Degrandi dhe më vonë edhe Kordinjano, e drejta e pronësisë u përdor aq shumë nga muslimanët saqë ata, që banonin sidomos nëpër rrethina e ndihmuan punën shkatërruese që kishte ushtruar koha mbi këtë manastir, duke marrë për nevojat e tyre gurët e manastirit.<sup>57</sup>

Nga kjo grabitje e materialit e pësoi edhe këmbanarja, të cilën këta banorë gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, e ulën deri në tre metra më poshtë, duke i marrë gurët e gdhendur në formë kubi për shtëpitë apo edhe për zbukurim të varreve të tyre.<sup>58</sup>

Nga rrënojat e këtij manastiri sot nuk ka mbetur shumë, kurse kulla katërkëndëshe që përmend Jirečeku është riparuar, jo plotësisht, në vitin 1991 nga popullsia dhe kleri. Aty çohet meshë edhe sot në raste festash tek një altar i improvizuar jashtë në vend të hapur, para të cilit janë vendosur edhe disa radhë ndejse betoni. Ky vend vizitohet vazhdimisht edhe sot e kësaj dite nga

<sup>54</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 271; Jules Alexandre Théodore Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie*. Par A. Degrand, Consul de France. Paris: H. Welter 1901, f. 82; F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

<sup>55</sup> A. Degrand, *Souvenirs*, f. 82.

<sup>56</sup> K. Jireček, "Skutari", në: *Forschungen I*, f. 114; A. Degrand, *Souvenirs*, f. 84.

<sup>57</sup> F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

<sup>58</sup> A. Degrand, *Souvenirs*, f. 84; F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

njerëz me halle që kërkojnë aty ngushllim dhe prehje shpirtërore.

Përveç rrënojave të sipërpërmendura ka edhe edhe mbetje nga ndërtesa të tjera të manastirit dhe nga muri rrethues i tij, rrënojat e të cilit ngrihen herë herë edhe mbi një metër mbi sipërfaqe. Kisha është shumë e madhe. Ajo ka një gjatësi mbi 22 metra dhe një gjerësi me gjithë mure rreth 860 cm. Muret ekzistuese janë pothajse fare të rrënuara dhe vende-vende ngrihen deri mbi 100 cm. Punimi i murit është i trashë, me gurë lumi të rrumbullakët dhe me rërë lumi e gelqere, megjithatë vihen re edhe gllendje të stilizuara në formë gërsheti, sidomos tek porta. Muret kanë afërsisht një trashësi prej 60 cm.<sup>59</sup> Kaq mund të themi për momentin në lidhje me këtë urdhër.

### Francëskanët Minorit

Në Shkodër kemi të pranishëm edhe Urdhrin Francëskan Minorit (*O.F.M., Ordo Fratrum Minorum*), të themeluar nga Francësku i Asizit (*Francesco d'Assisi \*1181/1182 - † 1226*).<sup>60</sup> Urdhri kishte si qëllim kthimin në idealet e krishtera ungjillore të varfërisë, lutje për faljen e mëkateve, tërheqje në vetmi dhe përkujdesje për të sëmurët, sidomos për ata që ishin me sëmundjen e lebrës, të cilët ishin të braktisur dhe të dëbuar nga të gjithë. Detyrë tjetër e urdhrit ishte ngritja dhe riparimi i kapelave dhe kishave të rrënuara apo të rëna.

Nga një vëllazëri besimtarësh, grupimi rreth Francëskut të Asizit u shndërrua në një urdhër lypsarësh, i cili po bëhej gjithnjë e më i madh. Në vitin 1216, Urdhri ishte përhapur në të gjithë Italinë, kurse në vitin 1217 e më vonë ai gjeti përhapje edhe në shumë vende të tjera si Francë, Spanjë, Gjermani dhe Palestinë. Kurse në Shqipëri Urdhri duhet të jetë ngulur për herë të parë diku në vitin 1219<sup>61</sup>. Në këtë vit, sipas një legjende Shën Francësku po kthehej nga Siria dhe kalon nëpër Shqipëri dhe ndalet në Lezhë, ku nëpërmjet shenjtërisë së tij bëri për vete shumë persona, ndër të cilët ishte edhe një mullis i qytetit,

<sup>59</sup> Matjet janë bërë nga Edmond Malaj, autori i këtij artikulli, në vitin 2012.

<sup>60</sup> Të dhënat për Urdhrin Francëskan marrë nga: Georg Schwaiger, *Mönchtum, Orden, Klöster: von den Anfängen bis zur Gegenwart; ein Lexikon*, München: Beck 1993, f. 189-191.

<sup>61</sup> Marin Sirdani, "Të venduemt e Francëskanëve nëpër viset e ndryshme të Shqypnisë 1240-1940", në: *Hylli i Dritës 1-2 (1940)*, f. 65.

Dom Lleshi, që e veshi petkun e pendesës nga dora e vetë Shën Françeskut.<sup>62</sup>

Vendosjen e hershme të këtij urdhri në Lezhë e mbështetet edhe në një rrasë të vendosur mbi derën e Kishës françeskane të Lezhës, në të cilën lexohej “*Hoc templum Fratrum Minorum edificatum est anno MCCXL*” (Ky tempull i Fretërve Minorit (Vëllezërve të Vegjël) është ndërtuar në 1240).<sup>63</sup>

Por data që nuk lë asnjë dyshim historik mbi ardhjen e Françeskanëve në Shqipëri është viti 1248, kur Innocensi IV dërgoi si argjipeshkv të Tivarit atin françeskan Johannes de Plano Carpini me detyrë që të kishte në kujdes dioqezat e Shqipërisë së Veriut e të Serbisë si dhe drejtimin e sivëllezërve të vet, që gjendeshin në ato vise.

Përsa i përket këtij Urdhri në Shkodër, ai duhet të ketë qenë i pranishëm që në shek. XIII, duke ndërtuar kuvendin e parë në Shkodër rreth viti 1288.<sup>64</sup> Ky kuvend së bashku me Kishën e Shën Mërisë në qytetin e Shkodrës (*templum et caenobim S. Mariae in urbe Scodrensi*) që ndërtuar nga mbretëresha (katolike) serbe, por me origjinë franceze Helena Anzhu, e shoqja e mbretit Urosh I dhe e ëma e Stefan Uroshit II Milutin.<sup>65</sup> Në të njëjtën kohë Helena kishte ndërtuar edhe një manastir tjetër në Ulqin, Manastirin e Shën Markut, të cilin po ashtu si kuvendin e Shën Mërisë në Shkodër ua dhuron në mënyrë ceremoniale françeskanëve, me qëllim që ti kenë të tyre dhe të banojnë në to.<sup>66</sup> Në këtë dokument përmendet edhe e motra e saj Maria de Chau, e veja e Anslem de Chau, mbase si kontributore në lidhje me ndërtimin e këtyre dy manastireve.<sup>67</sup> Këtë kuvend e gjejmë të dokumentuar edhe në dokumente të

<sup>62</sup> M. Sirdani, “Të venduemt ...”, në: *Hylli i Dritës 1-2 (1940)*, f. 66.

<sup>63</sup> P. Marin Sirdani O.F.M., “L’ insediamento dei Francescani nei diversi territori dell’ Albania 1240-1940. «Të venduemt e Françeskanvet neper vise të ndryshme të Shqypnis 1240-1940». Nota introduttiva e traduzione di Griselda Doka”, në: *Storia, Religione e Societa tra Oriente e Occidente*. Raccolta di saggi con studio introduttivo a cura di Attilio Vaccaro. Volume pubblicato con il patrocinio dell’ Eparchia di Lungro. Lecce: Argo 2013, 2014, f. 156.

<sup>64</sup> Gjush Sheldija, *Kryeipeshkvia Metropolitane e Shkodrës e Dioqezat Sufragane (Shënime Historike)*. Shkodër 1957-1958, f. 12.

<sup>65</sup> AAlb I, nr. 509.

<sup>66</sup> AAlb I, nr. 509.

<sup>67</sup> “*Helena. Regina Serbiae <una com sorre sua Maria de Chau?> templum et coenobium S. Mariae in Urbe Scodrensi et Monasterium S. Marci de Dulcinio a se extracta fratribus ordinis S. Francisci ab Observantia nunkupatis habitanda et possidenda tradit.*” AAlb I,

tjera të mëvonshme, si p. sh. në testamentin e fratit Shtjefën të Kuvendit të Shkodrës, të urdhrit të Shën Françeskut (*frater Stephanus de conuentu de Schutaro ordinis fratrum Minorum sancti Francisci*), i cili më vonë ndodhej në Raguzë, si kapelan i Manastirit të motrave të Shën Kjarës së Raguzës (*Ad presens capellanus monasterii sororum Sancte Clare de Ragusio*), nga ku bën edhe testamentin e tij të sipërpërmendur, me anë të së cilit i lë të gjitha pasuritë e tij Tole Parvisit, gruas së nipit të tij Mihaelit të Shkodrës (Mihael de Scutaro).<sup>68</sup> Këtij kuvendi duhet ti ketë përkatur edhe frati Sergio, mbase gardian i atyshëm.<sup>69</sup>

Françeskanët, më vonë duhet të ketë zënë vendin e Benediktinëve edhe në manastiret që ndodheshin përreth gjatë kësaj periudhe, por për këtë zëvendësim nuk kemi dokumente dhe nuk mund të japim të dhëna të tjera. Ndër kishat dhe kuvendet e françeskanëve në Shkodrën mesjetare mund të përmend këtu edhe kishën e dokumentuar si “*Kisha e Françeskanëve*” (1395). Me sa duket françeskanët në vitin 1391 patën probleme me priftërinjtë dioqezanë.<sup>70</sup>

Më tej ja vlen të thuhet nja dy fjalë edhe për *Kuvendin e Shën Françeskut dhe të Shna Ndout përtej Bunës*, i cili gjendej diku rrugës për në Shirokë dhe që u dogj nga trupat austro-hungareze në vitin 1918, gjatë tërheqjes së tyre.<sup>71</sup> Sipas Gj. Sheldisë, aty kishte bërë gjermime edhe Franc Nopça, i cili paska gjetur në rrënojat e tij dokumente dhe pasuri të tjera.<sup>72</sup> L. Shllkau shkruan se aty afër saj ekzistonte edhe një hospic\* françeskan që funksiononte edhe si strehë bujtinore, porse gjermadhat e tyre nuk mund të evidentohen më, pasi

nr. 509.

<sup>68</sup> AAlb II, nr. 539.

<sup>69</sup> “1398, 27. iunii Ragusii cons. minus gratiam facit aliquid extrahendi „fratri Sergio, vardiano Scutari” (Reform. 1397-1399)”, AAlb II, f. 143, ref. 3.

<sup>70</sup> Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f. 137.

<sup>71</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 12.

<sup>72</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 12.

\* Hospic (lat. *hospitium*) ka qenë dhe është një ndërtesë, pjesë e një manastiri apo në përkatësi të një urdhri fetar (franskanët, por jo vetëm, kanë një traditë të admirueshme në këtë drejtim), ku kanë gjetur strehim dhe përkujdesje njerëz në nevojë dhe të sëmurë. Sot *hospicet* shërbejnë më tepër për njerëz të cilët janë të sëmurë në mënyrë të pashërueshme dhe të cilëve u jepet përcjedhja e fundit.

topografia aty është përmbysur plotësisht.<sup>73</sup> Urdhrit françeskan i përkiste ipeshkvi i Shkodrës në vitin 1471, Françesk de Sanctis nga Padova<sup>74</sup>.

Në lidhje me françeskanët e Shkodrës mund të përmend së fundi edhe klerikun i lartë nga Shkodra Franciskus de Skutaro (Franciscus de Skutaro),<sup>75</sup> i cili ishte ipeshkëv i Drishtit nga viti 1404 deri në vitin 1424.<sup>76</sup>

Ipeshkëvinj të tjerë që in përkisnin këtij urdhri janë: Gega prej vendikut OFM – (1383)?<sup>77</sup>; dhe Laurenci II, OFM – 1449 – 14951 (sipas Farlatit, mbase këtu bëhet fjalë për Laurentius Michaelis Venetus (1442), i cili kishte shërbyer edhe në Manastirin e Shën Shirqit dhe të Shën Bakut<sup>78</sup>, i cili (dikur benediktin) në atë kohë duhet tu ketë përkitur françeskanëve. Një frat tjetër minorit që haset nëpër dokumente dhe duket se ka rëndësi të veçantë, është edhe françeskani shkodran Nikolla nga Shkodra (*Nicolaus de Scutaro*), i cili shkon në Venedik në tetor të vitit 1400, dhe i bën të ditura pakënaqësitë që kishin Kojë Zakaria dhe Dhimitër Jonima, ndaj osmanëve, si vasal i tyre që ishte.<sup>79</sup> E sollëm këtë rast (me dokumentin përkatës në fusnotë) jo si pa

<sup>73</sup> L. Shllaku, Shtegtimi i monumenteve, f. 75.

<sup>74</sup> Gj. Sheldija, *Kryeipeshkvia ...*, f. 12.

<sup>75</sup> AAV V, nr. 1392, f. 188, ref. 1. (Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Tomi (Vol.) 1-25. Palermo/ Napoli/ Roma/ Venezia/ München: Archivio di Stato di Venezia 1967-1972.)

<sup>76</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 238.

<sup>77</sup> Faqja Zyrtare e ipeshkëvisë së Shkodrës: Lista e ipeshkëvinjve. URL: <http://www.kishakatolikeshkoder.com/lista-e-ipeshkijve> (10. 4. 2017). Daniele Farlati nuk jep asnjë të dhënë në lidhje me këtë ipeshkëv.

<sup>78</sup> *Illyrici Sacri*. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.) Cituar si: D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 313.

<sup>79</sup> Kjo pasqyrohet në një dokument të kohës, ku thuhet se: “*U paraqit në praninë e zotërimit një farë mjeshtër Nikolla nga Shkodra, i urdhrit minorit, dhe tha se, kur ishte në ato vise, ai kishte marrë vesh, nga disa njerëz ndërmjetës ashtu edhe nga vetë goja e një zoti shqiptar, që quhet Kojë dhe është nën sulltanin dhe ka pjesën më të madhe të vendkalimeve nëpër të cilat turqit plaçkitin dhe vijnë për dëmtimin tonë në anët tona të Shkodrës, Drishtit dhe të viseve të tjera të atyshme, [kishte marrë vesh pra se ky Koja] nuk ishte aspak i kënaqur që ishte i bashkuar me sulltanin në fjalë, por e kish bërë këtë për shpëtimin e vet dhe të vendeve të veta, si dhe të shtetasve të vet; dhe se, qoftë për nderim ndaj perëndisë ashtu edhe për të ruajtur atdheun që të mos bjerë në dorën*”

vend, por për të shfaqur edhe rëndësinë politike dhe ndërmjetësuese që kishin fretërit moniritë në Shkodrën mesjetare.

Françeshkanët shkodranë i hasim po ashtu edhe jashtë trojeve shqiptare, për shembull në Zarë, Raguzë dhe në Venedik, kryesisht pas pushtimit osman të Shkodrës, por edhe më përpara. Në këtë artikull nuk mund ti përmendim të gjithë që na dalin nëpër dokumentet e shumta, por ja vlen që të cekim disa prej tyre. Në Raguzë përmenden në frati Shtjefni nga Shkodra që ishte vikar i Kuvendit të Fretërve Minoritë në Raguzë (*fratre Stephano de Scutari vicari fratrum Minorum conventus Ragusii*) që duhet të ketë qenë në këtë detyrë edhe vite më parë, gjatë periudhës 1300-1310<sup>80</sup>.

Në Zarë për shembull kemi të dokumentuar Aleksin nga Shkodra (*Allexium de Schutaro*) (1396), i cili ishte guardian e Kuvendit të Fretërve Minoritë në atë qytet (*vardianum loci et conuentus Fratrum Minorum*)<sup>81</sup>, dhe që ishte në marrëdhënie të ngushta edhe me klerikë shqiptarë të tjerë në Zarë, si p. sh. me presbiterin Theodorus, arqidiakon nga Shkodra (*dominus presbiter Theodorus archidiaconus Scutarensis*), apo presbiterin Valentino de Sigo, kanonik i Tivarit (*presbiter de Sigo canonicus Antibarensis*) (1396).<sup>82</sup>

Në Raguzë po ashtu kemi shembuj nga françeskanët shkodran që vepronin aty. Këtu mund të përmendim fratin Dhimitër nga Shkodra (*frater Dimitri de Scutaro*) (1348), i cili ishte kustod i Urdhrit të Fretërve Minoritë në Raguzë (*custos ordenin fratrum minorum*)<sup>83</sup> apo Andrean nga Shkodra (*Andreas de Scutaro*) (1347) që ishte guardian i Kuvendit të Fretërve Minoritë në Raguzë (*fratri Andree de Scutari guardiano conventus fratrum Minorum de*

---

e tij [sulltanit], do të pranonte të bashkohej me zotërimin tonë, dhe se, duke vepruar kështu shpreson të sjellë një tjetër zot, që quhet Dhimitër Jonima, i cili mban anën e tij [Kojës] dhe ishte gjithashtu i fuqishëm në ato vise me burra arme dhe me vendkalime." *Dokumente të Shek. XV*. Vëll. I, nr. 70.

<sup>80</sup> AAAlb. 1, f. 281. shih edhe: D. Farlati, *Illyrici Sacri VI*, f. 329 dhe 369.

<sup>81</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXXVIII. Typis Adophi Holzhausen. (AAAlb II), nr. 564.

<sup>82</sup> AAAlb II, nr. 564.

<sup>83</sup> AAAlb II, nr. 38.

Ragusio)<sup>84</sup>. Nëse do të vazhdonim më tej lista do të bëhej e gjatë dhe do ti kapërcente kufijtë e këtij artikulli. Megjithatë prania e françeskanë shkodranë në Raguzë dhe në qytete të tjera të Dalmacisë (Zarë, etj.) në poste të larta të këtij urdhri dëshmon në mënyrë të padiskutueshme për një traditë tashmë të konsoliduar të françeskanëve në Shkodrën e shekullit të XIV<sup>te</sup>, dhe për përgatitjen fretërve.

### Domenikanët ose predikuesit

Urdhri Domenikan (O. P.) në trojet shqiptare ka një histori që fillon me krijimet e këtij urdhri, qysh në shek. XIII.<sup>85</sup> Themeluesi i këtij urdhri klerikësh ishte Domenico da Caleruega (1170-1221), i cili e themeloi atë në Kastilie, duke u bazuar tek Rregullat Agostiniane.<sup>86</sup> Në trojet shqiptare ata e kanë zanafillën që në mesin e shek. XIII, dhe si shkak i ardhjes së tyre qenë problemet e mëdha që kishte Kisha Katolike me skizmatikët në rajonin tonë. Si rrjedhim i këtyre problemeve rreth vitit 1250 nga papa Inocens IV u dërguan në provincat kishtare të Pultit, Arbrit dhe Kunavisë dominikanë hungarezë, të cilët duhet të zhvillonin aktivitetin e tyre në ato provinca.<sup>87</sup> Ata kishin si detyrë të forconin ritin roman katolik në këto krahina dhe data e saktë, kur u dërguan nga provinca dominikane hungareze ishte 8 gusht 1250.<sup>88</sup>

Këta dominikanë hungarezë nuk u përhapën vetëm nëpër krahinat e Shqipërisë mesjetare por edhe në pjesë të mëdha të Bosnjës dhe të Dalmacisë. Përveç aktivitetit kundër skizmës ata qenë aktiv edhe kundër herezisë së Bogomilëve, që në atë kohë kishte gjetur përhapje nëpër ato krahina, sidomos në Bosnjë,<sup>89</sup> sepse pikërisht lufta kundër herezisë ishte ndër prioritetet e para,

<sup>84</sup> AAlb II, nr. 47, shën. 3.

<sup>85</sup> AAlb. I, nr. 169, 199, 244; M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 254; Gj. Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore ...*, f. 208.

<sup>86</sup> Karl Ploetz, *Enciclopedia della Storia*. Vol. 1: Evo antico e Medioevo. Milano: Mondadori 1974, f. 288.

<sup>87</sup> M. Šufflay, "Ungarisch-Albanische Berührungen", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 296.

<sup>88</sup> Ign Lamatsch, *Beiträge zur Geschichte des Dominikaner- oder Prediger-Ordens in allen Ordens-Provinzen*. Erstes Heft. Znaim: Martin Hoffman 1854, f. 211.

<sup>89</sup> Juliane Schiel, *Mongolensturm und Fall Konstantinopels: Dominikanische Erzählungen*

për të cilat qe themeluar urdhri.<sup>90</sup> Dominikanët e parë në trojet shqiptare i kemi në Ulqin dhe më vonë në Durrës, ku më 1278 ndërtuan një kuvend, i cili qe manastiri i parë dominikan në trojet shqiptare.<sup>91</sup> Urdhri krijoi lidhje me familje fisnike të atyshme si për shembull me Topiajt. Si klerik dominikan të kësaj familjeje mund të përmendim Dominik Topinë, i cili shpesh herë qe edhe ndërmjetës midis mbretit Ludvig dhe Raguzës.

Më vonë ata u përhapën edhe në krahinën e Shkodrës. Në shek. XV, në Shkodër ata kishin të tyre, kishën e Shën Elisë.<sup>92</sup> Edhe *Kisha e Zojës së Papërlyeme*, sipër kështjellës brenda mureve të kështjellës, e cila duhet të ketë qenë diku në afërsi të kishës së Shën Kollit pranë Portës, mbase mund ti ketë përkatur domenikanëve. Këtë hamendje e lidhim me faktin, se ajo përmendet nga Barleti gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës, me rastin e një kuvendi që u mbledh tek ajo, nën drejtimin e një murgu domenikan. Siç na njofton Barleti, në këtë kuvend që u mbledh, në kohën kur mbrojtësit panë ardhjen e sulltan Mehmetit II me një hordhi të madhe ushtarësh, “morën pjesë të gjithë italianët, shqiptarët e marinarët me qëllim që të merrnin zemër e të përgatiteshin për një rezistencë heroike”<sup>93</sup>. Aty predikimin për të ngritur moralin e mbrojtësve e mban një klerik shqiptar, i quajtur fra Bartolomeu i Urdhrit të Vëllezërve Predikues (Domenikanëve), të cilit Barleti i vë në gojë një fjalim mjaft të gjatë me efekte të shumta retorike.<sup>94</sup>

Një kishë tjetër e domeni-kanëve duhet të ketë qenë edhe *Kisha e Shën Vlashit*, në lagjen që ndodhej para qytetit, të ashtuquajtur “Nënshkodër” (*Sub-Scutari*). Aty në afërsi banonin edhe tregtare raguzan (*extra Scutari ad Sanctum Blasium 1433, S. Blasius prope civitatem Scutari 1444*).<sup>95</sup> Në një dokument të datës 4 shtator 1452 përmenden edhe murgjit “e Kuvendit të Shën Vlashit jashtë mureve të Shkodrës” (*monachi conventus s. Blasii extra muros Scutari*), të cilët u ankuan në Venedik për rrënimin e kësaj kishe bashkë me

*im diachronen Vergleich*, Berlin: Akademie 2011, f. 61.

<sup>90</sup> K. Ploetz, *Enciclopedia della Storia...*, Vol. 1, f. 288.

<sup>91</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f. 136.

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> Po aty, f. 52.

<sup>94</sup> M. Barleci, *Rrethimi ...*, f. 52-58.

<sup>95</sup> K. Jireček, “Skutari...”, f. 108.

manastirin nga ana e kapidentit venedikas, ngaqë ato ishin krejt afër mureve rrethuese të qytetit, atyre iu premtua dëmshpërblim i plotë.<sup>96</sup> Murgjit pretendonin, se manastiri nuk ishte ndërtuar në kohën e sundimit të mbretit Dushan (*sub Stephane rege Rascie*), gjë që Shufflay mendon se ka ndodhur vetëm për kishën, e cila sigurisht ishte themeluar nga raguzanët, mesa duket gjatë viteve të murtajës.<sup>97</sup> Kjo kishë duhet të jetë rinovuar sërish menjëherë, përderisa pas pushtimit osman ishte përsëri në këmbë.



Fig. 6. Kisha e Shën Vlshit në Shkodër.  
Foto nga Th. Ippen

Sipas Ippenit dhe Shllakut kjo kishë në kohën e Perandorisë Osmane për shkak të afërsisë së madhe me kalanë, ngaqë ndodhet poshtë saj, u kthye në banjë turke, e ashtuquajtura “*Hamami*” apo “*Banja e madhe*” për trupat e garnizonit osman<sup>98</sup>. Ky shndërrim duket se ka ndodhur në shekullin e errët XVI, pikërisht në vitin 1518.<sup>99</sup>

Ky objekt ka arritur në gjendje të mirë, të paktën deri në vitin 1958.<sup>100</sup> Shllaku ka konstatuar në afërsi të saj edhe rrënoja gurësh masiv të gdhendur, dhe këto rrënoja ishin në një vijë të drejtë me gjatësi 12 deri 13 metra, të cilat po sipas L. Shllakut mund të kenë qenë “*kolona me harqe, për të mbajtë*

<sup>96</sup> “Senato Mar. 4 fol. 144 v. Kronisti Manjo (Magno) (Jorga, Notes 3, 227 N. 1) përmend, që më 19 shtator 1448, gjatë një rënie zjarri të papritur por të tmerrshme në qytet (*krahaso* Ljubić 9, nr. 285) u futën natën për të gjetur mbrojtje një turmë njerëzish në një kishë të vogël “që është sipër murit” (*che e sopra il muro*) dhe aty gjetën vdekjen 500 persona”. M. Šufflay, “Kirchenzustände...”, f. 262.

<sup>97</sup> Po aty.

<sup>98</sup> Th. Ippen, *Skutari*, f. 23; L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve*, f. 42.

<sup>99</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 7.

<sup>100</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija arsimtar, Shkodër 1958, fl. 7.

përsipër një terracë, që shërbente edhe si vend zgjatimi për oborrin rrethues, fort të ngushtë, që kishte kisha e njëkohësisht aty ku takoheshin me ujin, si pendë për të pritë vërshimet e mundshme të lumit në kohë përmytjesh”.<sup>101</sup> Mbase këto rrënoja të dëshmuara nga Shllaku, që sot për fat të keq nuk janë më, i përkisnin kapitullit të Urdhrit Domenikan.<sup>102</sup> Si ipeshkvij dominikanë të Shkodrës mund të përmendim Antonin (prej vitit 1367) (Anton de Solutis (Soliciis)<sup>103</sup> dhe Emanuelin de Candia (prej 1451).<sup>104</sup> Domenikanët ishin të pranishëm edhe në qytete të tjera në afërsi të Shkodrës. Këtu mund të përmendim në Drisht ipeshkvin Dionisios de Knin (OSD) në vitin 1425,<sup>105</sup> apo në Dejë Ipeshkvin Gjonin OSD, që është i dokumentuar në këtë qytet në vitin 1397 dhe po në Dejë gjithashtu edhe Blasius de Zagabriis (OSD) në vitin 1401 dhe Blasius II (OSD) në vitin 1420.<sup>106</sup> Si ipeshkëv dominikan i fundit në Dejë por kësaj here titullar, figuron Gulielm Agieton (OSD), Ipeshkëv i Sardës, Sapës dhe Dejës (*Episcopus Sadensis, Sappatensis et Daynensis*) në vitin 1520.<sup>107</sup>

### Augustinianët

Përsa i përket historisë së Urdhrit të Augustinianëve (O. E. S. A.) ishte urdhri i katërt lypsar i periudhës mesjetare dhe vinte pas urdhrave të Dominikanëve, Françeskanëve dhe Karmelitëve. Ky urdhër u krijua në Romë në shek. XIII, si datë të fillimit të krijimit të tij është viti 1157, me krijimin e Urdhrit të Vilhelmitëve, pastaj në vitin 1224 u bë edhe asambleja e parë për themelimin e këtij urdhri nën papën Inocens IV në Romë. Procesi i themelimit të tij përfundoi në vitin 1256 nën papën Aleksandër IV me bulën papnore

<sup>101</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi ...*, f. 46.

<sup>102</sup> Giuseppe (Zef) Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*. (Pa vend botimi): Plejad 2010, f. 167.

<sup>103</sup> *Series episcoporum Ecclesiae Catholicae* quotquot innotuerunt A beato Petro Apostolo. A, ultis adjutus edidit P. Bonifacius Gams O. S. B. Zwëite unveränderte Auflage. Leipzig: Hiersemann 1931, f. 418.

<sup>104</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 310, 313. shih edhe: B. Gams, *Series...*, f. 418.

<sup>105</sup> Bonifacius Gams, *Series episcoporum Ecclesiae Catholicae*, Leipzig 1931, f. 406.

<sup>106</sup> B. Gams, *Series...*, f. 405-406.

<sup>107</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 232; Shih edhe: B. Gams, *Series...*, f. 406.

“*Licet Ecclesiae Catholicae*”.<sup>108</sup>

Urdhri ka si patron Shën Augustinin e Hippos (*Aurelius Augustinus*), figurën më të rëndësishme ndër etërit e Kishës Katolike, i lindur në Tagaste (sot Souk-Ahras në Algjeri) më 13 nëntor 359 dhe vdiq më 28 gusht 430 në Hippo Regius (sot Annaba) në Algjeri.<sup>109</sup> Në lidhje me ekzistencën e këtij urdhri në Shkodër hëpërhë kemi të dhëna të pakta. Si të dhënë të parë mund të përmend këtu ipeshkvin Christoforus, i cili u bë ipeshkëv i Shkodrës në 10 qershor të vitit 1401 dhe qëndroi si i tillë deri në dhjetor të këtij viti (1401).<sup>110</sup> Pastaj një vit më vonë nga ky urdhër kemi ipeshkëv në Shkodër Bartolomeo Vanni-n (1402 - 24 gusht 1403), i cili më parë kishte qenë ipeshkëv i Kalvit (*Vesscovo di Calvi 1395-1402*).<sup>111</sup> Ky ipeshkëv përmendet shkurt edhe tek Farlati<sup>112</sup>, por ai nuk e rendit në serinë e ipeshkëvinjve, edhe pse ai me të vërtetë mund të ketë qenë për një vit ipeshkëv i Shkodrës.

Për praninë e këtij urdhri në Shkodër nga flet në mënyrë indirekte edhe fakti që Fugurja e Zojës së Shkodrës u vendos në një kishë augustiniane në Genazzano, na çon në supozimin se ajo duhet të jetë mbartur dhe çuar në Itali pikërisht nga pjesëtarë të këtij urdhri. Përndryshe si shpjegohet që kjo fugure në Genazzano shkoi e përfundoi pikërisht në një kishë që i përket këtij urdhri. Gjithsesi historikisht si të pranishëm në afërsi të Shkodrës mund të përmendim këtu Ipeshkvinjtë e Drishtit Nikolaus, në vitit 1322, i cili i përkiste urdhrit të Eremitëve të Shën Augustinit, apo në vitin 1414 ipeshkvin e Dejës Prebislavin,

<sup>108</sup> Augustinerorden. URL: <http://www.augustiner.de/de/geschichte/augustinerorden/index.html> (31.10. 2013)

<sup>109</sup> Biographisch-Bibliographisches Kirchenlexikon. Bd. I. herausgegeben von Friedrich-Wilhelm Bautz. Hamm: Traugott Bautz 1990, spalten 272-300.

<sup>110</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 310-311. Shih edhe: Dokumente për historinë e Shqipërisë të Shek. XV. I. (1400-1405). Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi. Redaktor përgjegjës Aleks Buda. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë 1987, nr. 116.

<sup>111</sup> Shiko faqen zyrtare të Ipeshkvëvisë së Teano-Calvi: Cronotassi dei Vescovi. URL: [http://www.diocesiteanocalvi.it/pls/teanocalvi/v3\\_s2ew\\_consultazione.mostra\\_pagina?id\\_pagina=22867](http://www.diocesiteanocalvi.it/pls/teanocalvi/v3_s2ew_consultazione.mostra_pagina?id_pagina=22867) (17. 4. 2017)

<sup>112</sup> “*E catalogoantistitum Scodrensiū expungi oportet Bartholomeum, quem Ferdinandus Ughellus tom, 10. Ital. Sacr. in Addit pag. 240. e Calvensi Ecclesia provinciae Caouanae trasnlatum fuisse ait ad Ecclesiam Scutarensē an. 1403. ex libr. Obl. Cam. Bonifacii IX. Sed humus translationis Scodrensis ne verbum quidem in eo libro reperit reverit Card. Carampius.*” D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 310, 313.

i cili gjithashtu ishte agostinian (O. S. A.)<sup>113</sup> Mbi aktivitete të tjera të këtij urdhri apo mbi praninë e tij në Shkodër nuk kemi të dhëna të tjera të dokumentuara. Ndërsa u ipeshkvij titullarë të Shkodrës që i përkisnin këtij urdhri mund të përmendim Jacobus Humanus<sup>114</sup>, O.E.S.A. † (10 mars 1511 - † 10 gusht 1517) dhe Petro de Cardona, C.R.S.A. (26 shkurt 1518 - †1522).<sup>115</sup> Ky i fundit në fakt i përkiste një kongregacioni që ndiqte rregullat e Shën (C.R.S.A = *Sacer et Apostolicus Ordo Canonorum Regularium Sancti Augustini*).

### Presbiterat

Nëpër dokumentet mesjetare, në lidhje me klerikët e Shkodrës dhe të rrethinave paraqitet shumë shpesh fjala *presbiter* (lat. presbyter) dhe *dom* apo *don* (*dompnus*), pa iu referuar një urdhri të veçantë, poqë për të cilët mendojmë se bëhet fjalë kryesisht për klerin dioqezan. Si koncept, fjala *presbyter* e cila e ka origjinën nga greqishtja biblike (greq. *πρεσβυτησ*)<sup>116</sup>, do të thotë *pjesëtar i këshillit të pleqve, një ndër udhëheqësit e komunitetit*<sup>117</sup> dhe nënkupton një pozicion drejtues në një bashkësi të krishterësh. Në Kishën Katolike fjala *presbiter* do të thotë *prift*. Si ofiq kishtar presbiterin e hasim qysh me bashkësitë e para të krishtera të Besëlidhjes së Re, nëpër kishat e krishtera të ndryshme të kohës së sotme, që nga Kisha Katolike e deri tek kishat protestante dhe ato të lira të krishtera.

*Presbiterat pra janë kleri i dioqezave dhe i famullive që nuk i përkisnin*

<sup>113</sup> B. Gams, *Series...*, f. 406.

<sup>114</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 320-21.

<sup>115</sup> Më gjerë në lidhje me të shih tek D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 321.

<sup>116</sup> Menge-Güthling. *Enzyklopädisches Wörterbuch der griechischen und Deutschen Sprache*. Erster Teil: Griechisch-Deutsch. Unter der Berücksichtigung der Etymologie von Prof. Dr. Hermann Menge. 17. Aufl. Berlin-Schönberg: Langenscheidt KG 1962, f. 578.

<sup>117</sup> Vep. 11, 30, në: Bibla. Shkrimi i Shenjtë: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e re. Përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj. Ferizaj: Drita 1994, f. 1562. **Shënim:** Për të mos i zgjatur, këtu dhashë vetëm një shembull nga Besëlidhja e Re në të cilën ka plot shembuj të tjerë, por presbiterët si *pleq*, drejtues të komuniteteve janë të pranishëm edhe në Besëlidhjen e Vjetër. Shih për më tepër edhe: *Wörterbuch des Christentums ...*, f. 994-995.

një urdhri të caktuar dhe vareshin nga ipeshkvi apo kryeipeshkvi, i cili ishte kreu (bariu) i një dioqeze apo kryedioqeze. Presbiterët në Mesjetë kishin edhe nxënësit e tyre. Këta nxënës pajtoheshin tek presbiterët për disa vite me qëllim që të mësonin në lidhje me to. Gjatë qëndrimit në shërbim të tyre, këta nxënës deklaroronin se do t'i bindeshin presbiterit në të gjitha urdhrat e udhëzimet dhe do të silleshin ndaj tyre në mënyrë të ndershme dhe besnike, duke mos e vjedhur dhe duke ruajtur sendet e tij. Nga ana e tij presbiteri ishte i obliguar që t'i siguronte nxënësit të tij gjatë gjithë kohës që qëndronte tek ai, ushqimin, strehimin dhe veshmbathjen, po ashtu një mësimdhënie siç e kërkonte rregulli<sup>118</sup>. Në lidhje me këta priftërinj në masë të madhe na shfaqen kryesisht ata të Drishtit por edhe të Shkodrës dhe qyteteve të tjera të afërsi të saj.

Këtu, si ndër të parët mund të përmendim arqipresbiterin Andrea, presbiterin Vito, presbiterin Trifon dhe presbiterin Teodor (archipresbytero Andrea, presbytero Vito, presbytero Triphone et presbytero Theodoro), të gjithë të dokumentuar më 27 prill 1251 në pallatin peshkopal të Shkodrës (in domo episcopi), si të pranishëm kur presbiteri Dessigna, në cilësinë e nuncit të Ipeshkvit të Trebinjes (Tribuniensis) paraqitet tek ipeshvi i Shkodrës dhe i çon kërkesën e papës, që të paraqitet brenda tetë muajve ose ai vetë ose i përfaqësuar nga një prokurator.<sup>119</sup> Më 2 qershor të vitit 1319 dokumentohet edhe don Andrea nga Shkodra (don Andrea de Scutari), i cili shkon në Raguzë për të gjetur tre sharrëtarë specialistë (segatores ... de arte sechete = mbase gllendës druri), për ti marrë me vete në Shkodër, me qëllim që të punonin të

<sup>118</sup> Si shembull pasqyrues shërben marrëveshja e presbiterit Aleksius Barilok nga Drishti dhe e nxënësit të tij Gjergjit, të birit të Joni Dukës nga Pulti i Vogël (nga krahinat e Dejës dhe të Sapës). Në marrëveshje janë deklaratat e të dyve. Me anë të deklarimit të tij, Gjoni bën të ditur se për tre vitet e ardhshme vihet në dispozicion të presbiterit si nxënës i tij Aleks i Drishtit, me mbiemër Barilok. Gjergji premton se do t'i bindet urdhrave, këshillave dhe detyrave të vëna nga Aleks, që të shkojë, të qëndrojë apo të rikthehet (aty ku e dërgon ai me porosi). Më tej ai zotohet se do t'u rrijë besnik punëve të presbiterit Aleks dhe se do të ruajë sendet e tij, nuk do ta grabisë dhe nuk do të bëjë asnjë lloj vjedhjeje karshi tij, qoftë pa ose me dëshirë dhe se do të jetë dakord e do t'i bindet çdo detyre të ngarkuar prej tij. Nga ana e tij Aleks premtonte dhe e ndjente veten të detyruar që t'i siguronte Gjergjit qoftë ushqimin, veshjen dhe strehimin, qoftë mësimin me korrektësi në punët e presbiterit. AAlb II, nr. 377.

<sup>119</sup> AAlb I, nr. 205.

gjithë korin e kishës katedrale të Shën Shtjefnit.<sup>120</sup>

Po në vitin 1319 dokumentohet në Shkodër, si një ndër klerikët dioqezanë që qëndronin pranë ipeshkvit Pashk të kësaj ipeshkvie (*Pasqua dei gratia episcopus Scutariensis*) edhe dom Shtjefni (*dominus Stephanus*)<sup>121</sup>, i cili për mendimin tonë nuk duhet të ngatërrohet me fratin Shtjefën, vikar i Kuvendit të Fretërve Minoritë në Raguzë, për të cilin folëm më sipër. Po ashtu në vitin 1319 kemi të dokumentuar edhe diakonin shkodran Dhimitri i Shkodrës (*diacono Dimitri de Scutaro*), për të cilin mendojmë se i përket gjithashtu këtij grupi klerikal. Don Shtjefni dhe diakoni Dhimitër përmenden këtu si dëshmitarë në lidhje me një hua prej 600 soldash të mëdha venedikase që Ipeshkvi i Shkodrës Pashku dhe Jurek Minosllaviqi, nunc i mbretit serb Urosh, ia kishin marrë komunës së Raguzës, nëpërmjet disa raguzanëve.<sup>122</sup>

Më tej përmenden edhe presbiteri Theodorus, arkidiacon nga Shkodra (*dominus presbiter Theodorus archidiaconus Scutarensis*) (1396)<sup>123</sup>, të cilin e kemi të dokumentuar në Zarë. Nëpër dokumente raguzane, më së shumti nëpër testamente na përmenden edhe priftërinj të tjerë të Shkodrës si Marini i Shkodrës (*Marinus de Scutari, presbiter Ragusinus*) (1350-1398)<sup>124</sup> apo Dhimitri i Shkodrës (*Demetrius de Scutaro, presbyter Ragusinus*) (1390)<sup>125</sup>, të cilët që të ty rezultojnë si priftërinj në Raguzë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIV.

Më tej, po në Raguzë është i dokumentuar edhe dom Andrea i Shkodrës (*dompni Andree de Schutaro*) i dokumentuar në vitin 1398<sup>126</sup>, apo dom

<sup>120</sup> “[1319], 2 iunii, Ragusii: Don Andrea de Scutari ad laborandum “totium corium ecclesie Sancti Stephani de Scutaro” secum ducit Scutarum tres segatores “de arte sechete” AAlb I, nr. 646.

<sup>121</sup> AAlb. I, nr. 658.

<sup>122</sup> “13, 27 octobris <Ragusii>: “Pasqua dei gratia episcopus Scutarensis et Jurech Minosclavich, nuntii domini regis Vrossi” se pro debito quorundam Ragusinatorum a communi Ragusii 600 grossos. Venetorum recepisse declarant. Praesentibus (inter altos) “domino Stephano de Scutari, diacono dimitri de Scutari”. AAlb. I, nr. 658.

<sup>123</sup> AAlb II, nr. 564.

<sup>124</sup> AAlb II, nr. 66.

<sup>125</sup> AAlb II, nr. 539, ref. 4.

<sup>126</sup> “Testamentum “dompni Andree de Schutaro” 1398, 29. septembris factum extat in libro ‘testamenta 1391-1402, fol. 112v.” AAlb II, f. 143, ref. 4.

Dhimitri i Shkodrës (*dompni Dymitrii de Scutaro*), i dokumentuar në vitin 1390.<sup>127</sup> Dom Andreas i Shkodrës, i lartpërmendur bënte edhe pelegrinazh në vendet e shenjta si në Romë, etj, në shërbim të besimtarëve, në këmbim të një shume të caktuar që atij i duheshin për udhëtim dhe për ti ofruar në vendet ku shkonte.<sup>128</sup>

Si përfundim, si presbiterin më të rëndësishmin mund të përmendim këtu Marin Barletin (*Marinus Barletius, presbyter Scodrensis*)<sup>129</sup>, i cili është autori i veprave madhore “*Mbi Rrethimin i Shkodrës*” (*De Obsidione Scodrensi*) dhe Historia e Skënderbeut (*Historia de vita et gestis Scanderbegii*), dhe që vlen si babai i historiografisë shqiptare.

\* \* \*

Këto pra ishin shkurt disa të dhëna në lidhje me urdhrat kishtarë në krahinën e Shkodrës Mesjetare.

— o —

## Edmond Malaj

### Church Orders in Shkodra and its suburbs during Medievalism

#### *Summary*


The aim of this article is to give an overview over the religious catholic orders in the region of Shkoder concentrating especially in the area of the medieval city. In the Medieval Shkodra clergymen and monks were present who belonged to the orders of Benedictines, Dominicans, Franciscans, and

<sup>127</sup> “*Anno 1390 memoratur „Barbara mater dompni Dymitrii de Scutaro” (Precetti 1390).*” AAlb II, f. 143, ref. 4.


<sup>128</sup> “*(sine dato). Dominus Andreas de Scutari fuit confessus habuisse causa eundi Romam pro anima predicti Bratoe perperos XX. Distrib. testament. 1349—1354, fol. 14.*” AAlb II, nr. 47.

<sup>129</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 303.

then in the capacity of the bishop of Drishti were mentioned priests, who belonged to the orders of Norbertians (premonstratens), Augustinians and Mercedarians. I focused mainly on the presence of the first three great orders that are mostly documented in the Middle Ages in Shkodra and the suburbs. These are the Benedictines, Dominicans and Franciscans, and besides these there were also the diocese clergy.



Imazhi i plotë i  
Zojës së Këshillit të Mirë  
në Genazzano, 2017



Shpërngulja e Zojës së Shkodrës në Genazzano  
Pikturë, vaj në pëlhurë, shek XIX  
Simon Rrota, Kolë Idromeno, Ndoc Martini



Çmimi 1000 lekë